| 83. "Gjatësia e zanoreve në të folmen e Karadakut të Shkupit", Takimi i dhjetë vjetor i Institutit Alb-shkenca, Shkup, 28-30 gusht 2015.  |  |   |
| <b>Të dhënat për punimet e tjera:</b>   |  |   |
| <b>Monografi shkencore dhe tekste mësimore parauniversitare e universitare</b>  |  |   |
| 84. "Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit", Vatra, Shkup, 2005, 225 faqe (monografi).  |  | 3 |
| 85. "E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit", Logos-A, Shkup, 2014, 500 f. (monografi).   |  | 2 |
| 86. "Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe" (libër mësimor universitar), Interdiskont, Shkup, 2005, 305 faqe, ribotuar më 2011.   |  | 4 |
| 87. "Фонетика и фонологија на албанскиот јазик" (libër mësimor universitar në maqedonisht), Menora, Shkup, 2008, 312 faqe; ribotuar nga Universiteti "Shën Qirili e Metodi", Shkup, 2011.   |  | 3 |
| 88. "Dialektologjia e gjuhës shqipe" (në bashkautorësi), Shkup, 2014, 322 f. (libër mësimor universitar).   |  | 2 |
| 89. "Gramatika e gjuhës shqipe për klasën III", Prosvetno Dello, Shkup, 1992, 1994, 1996, 1998; 80 f.   |  |   |

|  |  |   |
|--|--|---|
| 90. "Gjuhë shqipe për klasën V" (tekst shkollor, lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të tetëvjeçareve të Maqedonisë, në bashkautorësi), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, botimi II, 2008, botimi III, 2015, 122 faqe.  |  |   |
| 91. "Gjuhë shqipe për klasën VI" (tekst shkollor, lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të tetëvjeçareve të Maqedonisë, në bashkautorësi), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, botimi II, 2009, 132 faqe.                   |  |   |
| 92. "Gjuhë shqipe për klasën VII" (tekst shkollor, lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të tetëvjeçareve të Maqedonisë, në bashkautorësi), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, 182 faqe. |  |   |
| 93. "Gjuhë shqipe për klasën VI" (tekst shkollor për arsimin fillor nëntëvjeçar, në bashkautorësi, për nxënësit shqiptarë), Shkup, 2011, botimi II 2015, 150 faqe.   |  |   |
| 94. "Fletore pune e gjuhës shqipe për klasën VI" (tekst shkollor për arsimin fillor nëntëvjeçar, në bashkautorësi, për nxënësit shqiptarë), Shkup, 2011, 80 faqe.  |  |   |
| 95. "Gjuhë shqipe për klasën VI" (tekst shkollor, lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të nëntëvjeçareve të Maqedonisë, në bashkautorësi), Shkup, 2011, 132 faqe.  |  |   |
| 96. "Fletore pune e gjuhës shqipe për klasën VI" (tekst shkollor për arsimin fillor për nxënësit joshqiptarë të nëntëvjeçareve të Maqedonisë, në bashkautorësi), Shkup, 2011, 70 faqe.   |  |   |
| 97. "Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar" (në bashkautorësi, tekst shkollor), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2004, f. 5-138.  |  | 2 |
| 98. "Kulturë gjuhe" (në bashkautorësi, në dorëshkrim), dispensë për studentët e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit, Prizren, 2015.   |  |   |

Vërejtje lidhur me tabelën 2:

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së (neni 175, 176 dhe 177). *Punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare* konsiderohen, në radhë të parë, punimet e publikuara në revista me "faktor impakti" e pastaj edhe punimet origjinale të botuara në revistat shkencore ndërkombëtare me "peer review" në lëminë ku konkurron kandidati.

Në këtë tabelë duhen të shënohen vetëm punimet nga fusha e ngushtë shkencore në të cilën kandidati konsiderohet "autor kryesor". Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi personale lidhur me punimet e radhitura në këtë tabelë. Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t'i dorëzohen si dëshmi Komisionit të Studimeve së bashku me raportin e recensionit.

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;

2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijojnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

Kandidati Asllan Hamiti nga viti 1986 ka punuar në Katedrën e Gjuhë dhe të Letërsisë Shqiptare në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" të Shkupit, duke u zgjedhur në vijimësisë bashkëpunëtor e mësimdhënës në titujt mësimorë: stazhant (1986), asistent i ri (1988) asistent (1994), docent a profesor asistent (1999), profesor i asocuar (2004) dhe profesor (2009) për lëndët Fonetikë dhe fonologji e gjuhës shqipe, Gramatikë e gjuhës shqipe 1, 2; Dialektologji shqiptare 1, 2; Drejtshkrim e drejtshqiptim, Praktikum i gjuhës shqipe, Kulturë gjuhe dhe Histori e gjuhës shqipe. Gjatë viteve 2003-2005 aplikanti dr. sc. Asllan Hamiti ka qenë ftuar të mbajë kursin e gjuhës shqipe për të huajt në Universitetin e Punëtorëve "Koço Racin" në Shkup. Në vitin shkollor 2007/2008 ishte titullar i lëndës Gjuhë shqipe 1, 2 për të huajt në Fakultetin e Menaxhmentit dhe të Teknologjisë Informativë në Shkup, ndërsa në vitin akademik 2009/2010 ishte ftuar të ligjëronte lëndën Gjuhësi historike në shkallën e tretë në studimet master për gjuhë shqipe në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Vite me radhë ka mbajtur mësim edhe në studimet pasuniversitare si dhe në studimet e ciklit të tretë në Degën e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Shkupit. Deri më tani ka marrë pjesë si anëtar komisioni për vlerësimin e përshtatshmërisë së temave dhe të kandidatëve si dhe miratimin e tyre, mbrojtjen e disa magjistraturave dhe të doktoratave. Është udhëheqës shkencor i disa kandidatëve për magjistraturë (tani master) dhe doktoraturë në Universitetin e Shkupit dhe në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Është mentor i akredituar për udhëheqje shkencore të kandidatëve si dhe përgjegjës i studimeve të shkallës së tretë – studimeve të doktoraturës për Degën e Gjuhësisë në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Ishte titullar i lëndëve Drejtshkrim dhe Drejtshqiptim më vitin akademik 2014-2015 në Fakultetin Pedagogjik "Klimenti i Ohrit" në Shkup.

Në vitin akademik 2014-2015 (në semestrin dimëror e veror) qe angazhuar si mësimdhënës për lëndët Kulturë gjuhe, Histori e gjuhës standarde dhe Fonetikë në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit. Profesionalizmi, zelli dhe përkushtimi i tij dëshmohet edhe me përgatitjen e një dispense për lëndën Kulturë gjuhe (në bashkautorësi) për nevojat e studentëve të Degës së Gjuhës Shqipe të këtij universiteti.

Kandidati dr. sc. Asllan Hamiti për punën e tij të suksesshme ka marrë disa mirënjohje e lëvdata. Është laureat i çmimit "Goce Dellçev" i dhënë si mirënjohje shoqërore për arritje të veçanta e me vlerë për Republikën e Maqedonisë në fushën e shkencës për vitin 2014. Ai është anëtar i Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe.

### **3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim**

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)*

Përveç punës së frytshme pedagogjike dhe kërkimore-shkencore, kandidati Asllan Hamiti ka dhënë ndihmesë edhe në organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë si dhe përgjithësisht të arsimit të lartë. Po sjellim disa nga aktivitetet e aplikantit:

1. Bashkëpunëtor i projektit kërkimor-shkencor "Të folmet shqipe në Maqedoni", realizuar nga Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare e

- Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup në periudhën kohore 1995-1997.
2. Recensent për zgjedhjen e disa asistentëve, lektorëve dhe profesorëve në Universitetin e Shkupit e të Tetovës.
  3. Anëtar profesional për nostrifikimin e diplomave.
  4. Recensent i shumë teksteve shkollore për Gjuhë e Letërsi Shqiptare.
  5. Redaktor gjuhësor e përkthyes i disa veprave.
  6. Bartës i projektit kërkimor-shkencor "Vëzhgime krahasimtare fonologjike ndërmjet shqipes e maqedonishtes", 2000-2003.
  7. Ekspert lokal dhe trajnues në projektin ndërkombëtar Pace 2, për trajnimin e 100 përkthyesve dhe interpretuesve (pjesëtarë joshumicë në Maqedoni) nga shqipja në maqedonisht dhe anasjelltas, organizuar nga Qeveria e Maqedonisë dhe British Council në vitet 2005-2006 në Shkup.
  8. Anëtar i komisionit për hartimin e programit mësimor të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi për klasën IV, V dhe VI (si gjuhë amtare), dhe Gjuhë shqipe për klasën VI (lëndë me zgjedhje) në Byronë e Zhvillimit të Arsimit në R. e Maqedonisë, 2007- 2008.
  9. Anëtar i këshillit mësimor-shkencor në Fakultet, anëtar i shumë grupeve punuese, komisioneve të ndryshme, sekretar i Katedrës, aktualisht koordinator i programeve mësimore të Katedrës sipas Sistemit të Bolonjës, kryetar i komisionit për evoluimin e programeve mësimore në Fakultet, kryetar i komisionit për shqyrtimin e ankesave të studentëve në regjistrimin e vitit 2010/2011.
  10. Bashkëpunëtor i jashtëm për lëndën Gjuhë shqipe (për joshqiptarë) në fakultetin privat për Menaxhment dhe Teknologji Informative në Shkup në vitin shkollor 2007/2008.
  11. Përgjegjës i Katedrës së Gjuhës dhe i Letërsisë Shqiptare në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" të Shkupit nga viti 2008-2011.
  12. Ekspert lokal dhe trajnues në projektin ndërkombëtar organizuar nga Qeveria e Maqedonisë dhe British Council në vitet 2012-2013 në Shkup.
  13. Mësimdhënës dhe mentor i akredituar (i licencuar) i studimeve të doktoraturës në degën e gjuhësisë shqiptare të Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup.
  14. Ligjërues i lëndës Gjuhësi historike në vitin akademik 2009/2010 në shkallën e tretë në studimet master për gjuhë shqipe në Universitetin Shtetëror të Tetovës.
  15. Përgjegjës i studimeve të shkallës së tretë – studimeve të doktoraturës për degën e gjuhësisë në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" në Shkup nga viti 2011.
  16. Bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët Kulturë gjuhe, Histori e gjuhës standarde dhe Fonetikë në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.

Dr. sc. Asllan Hamiti ka dhënë ndihmesë edhe në organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë, në hartimin e programit mësimor në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Prizren etj. Ishte koordinator i programeve mësimore të reja me sistemin e Bolonjës, anëtar i komisionit për pranimin e studentëve të rinj, anëtar i komisionit profesional i Programeve mësimore të gjuhës e

të letërsisë shqiptare në Byronë e Zhvillimit të Arsimit si organ i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës së R. së Maqedonisë; kryetar i komisionit për nostrifikimin e diplomave Gjuhë e Letërsi Shqiptare të marra jashtë Maqedonisë, kryetar i komisionit për evoluimin e programeve mësimore të Fakultetit të Filologjisë së Shkupit etj.

#### **4. Mobiliteti i kandidatit**

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)*

Kandidati Asllan Hamiti studimet themelore i mbaroi më vitin 1985 në Fakultetin e Filologjisë, Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Shkup me notë mesatare mbi nëntë. Në vitin akademik 1986/87 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Degën e Gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë dhe më vitin 1992 mori gradën shkencore magjistër i filologjisë. Më vitin 1996 për qëllime shkencore ka qëndruar në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë.

Doktori më vitin 1999 në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi", në Shkup në temë "E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit". Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë së Kosovës ka nostrifikuar diplomën e doktoraturës së aplikantit me vendimin nr. 6/70 të datës 18. 06. 2015.

#### **5. Titulli i cili propozohet**

*(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).*

Në bazë të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkurs dhe në sajë të arritjeve të të paraqiturve në këtë konkurs, duke pasur konsideratë ndaj të gjithëve, nga tre konkurrentët: përzgjedhëm dr. sc. Asllan Hamiti dhe Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit kemi nderin t'i propozojmë që kandidatin dr. sc. Asllan Hamiti ta zgjedhë në titullin profesor i asocuar (prof. asoc. dr.) në Fakultetin e Filologjisë për lëndët Kulturë gjuhe, Fonetikë, Histori e gjuhës standarde, Dialektologji, Metodologji e gjuhës amtare dhe Filologji shqiptare (në programin e Gjuhës Shqipe).

Nga të dhënat bio-bibliografike mund të konstatohet se kandidati dr. sc. Asllan Hamiti është pedagog i shquar, studiues i shqipes dhe filolog i spikatur. Në veprimtarinë e tij pedagogjike e shkencore hetohet një ngritje e vazhdueshme cilësore. Që në studimet themelore u dallua si studenti më i mirë i gjeneratës, duke u dëshmuar si studiues i zellshëm edhe në studimet e magjistraturës e me një formim të shëndoshë në punimin e doktoraturës.

Aplikanti Asllan Hamiti është pedagog i shkëlqyeshëm. Këtë e ka dëshmuar si titullar lëndësh në tre ciklet akademike: në studimet themelore, në ciklin e dytë e të tretë në disa universitete, përfshirë edhe angazhimin e tij si bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin e Filologjisë në Prizren në vitin akademik 2014-2015 për disa nga lëndët për të cilat ka konkurruar. Ai është dëshmuar edhe si udhëheqës shkencor i suksesshëm, duke mentoruar dhjetëra kandidatë nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria për studimet e magjistraturës e të doktoraturës (me sistemin e mentorimit dhe me sistemin e Bolonjës).

Përgatitja e tij e shkëlqyeshme profesionale e pedagogjike dëshmohej edhe me botimin e disa teksteve mësimore për arsimin parauniversitar e universitar. Si autor ose bashkautor deri më tani ka botuar shtatë libra mësimorë me fletore pune për arsimin fillor, një për arsimin e mesëm dhe dy tekste universitare: një për fonetikën e shqipes standarde (të botuar edhe në gjuhë të huaj) si dhe një libër për dialektologjinë shqiptare.

Veprimtaria e kandidatit dr. sc. Asllan Hamiti edhe në fushën e studimeve gjuhësore është e frytshme. Ai deri më tani ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore albanologjike në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni si dhe ka botuar mbi 80 artikuj që shtjellojnë çështje të ndryshme të kulturës së gjuhës, të sistemit fonetik e morfologjik, të dialektologjisë, të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera, për ndihmesat e vyera të gjuhëtarëve shqiptarë etj., si dhe monografitë "Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit" (2005), "E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit" (2014).

Përgjithësisht, shkrimet e tij i përshkon profesionalizmi, mbështetja në literaturë të gjerë, serioziteti, përkushtimi, saktësia, objektiviteti, korrektësia, qartësia si dhe njohja e thellë dhe zbatimi i mundësive shprehëse të shqipes. Sidomos në monografinë kushtuar shqipes së shekullit XIX, ashtu edhe në monografinë dialektore dëshmohej se kandidati dr. sc. Asllan Hamiti ka përgatitje solide profesionale, njeh metodologjinë e punës shkencore dhe mbarështron e shtjellon materien në shqyrtim me stil shkencor e gjuhë të rrjedhshme, të thurur për lakmi. Ka marrë pjesë edhe në disa projekte kërkimore-hulumtuese e trajnuese me karakter regjional. Ai është laureat edhe i një çmimi për shkencë si dhe anëtar i Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe. Personalitetin e tij e karakterizojnë edhe virtytet e larta njerëzore që duhet t'i ketë mësimdhënësi. Është një nga ata që kanë vlera të larta morale e humane: i qetë për nga karakteri, i ndërgjegjshëm, vë raporte të mira bashkëpunuese me studentë e kolegë, i përgjegjshëm, serioz e i përpiktë në kryerjen e të gjitha obligimeve të punës.

Marrë në përgjithësi, veprimtaria e deritashme pedagogjike, arsimore e shkencore e kandidatit dr. Asllan Hamiti ndërlidhet ngushtë me lëndët për të cilat ka konkurruar për zgjedhje në mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit.

Në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, të publikuar në faqen e internetit në adresën <http://www.uni-prizren.com> si dhe në disa gazeta për zgjedhje në mësimdhënës për lëndët: Kulturë gjuhe, Fonetikë, Histori e gjuhës standarde, Dialektologji, Metodologji e gjuhës amtare dhe Filologji shqiptare (në Fakultetin e Filologjisë, në programin e Gjuhës Shqipe) kanë konkurruar tre kandidatë: dr. sc. Asllan Hamiti, dr. sc. Rovena Vata dhe dr. sc. Ragip Gjoshi. Mbështetur në dosjet e tyre, po japim të dhëna bio-bibliografike dhe vlerësime edhe për këta kandidatë.

## 2. Të dhënat mbi kandidaten:

Emri dhe mbiemri: **Rovena Vata**  
Datëlindja dhe vendlindja: 26. 05. 1985, Bajram Curr, Tiranë  
Gradat shkencore: doktor i shkencave të filologjisë (në fushën e letërsisë)  
Titujt akademikë:  
Viti kur është fituar titulli aktual:  
Departamenti/fakulteti:

Universiteti:

Në bazë të të dhënave që kemi në dispozicion, kandidatja dr. sc. Rovena Vata ka magjstruar dhe doktoruar në fushën e letërsisë, përkatësisht masterin shkencor në drejtimin Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar në Universitetin e Tiranës në mikrotezën "Frymët, demonët dhe besëtytënitë në rrëfenjat e Kutelit, Gogolit dhe Turgenievit (aspekte të demonologjisë krahasuese)"; ndërsa doktoroi në temë "Miti i malit në letërsinë shqipe: Fishta, Koliqi, Migjeni, Camaj" në Qendrën e Studimeve Albanologjike me notën 10.

Ajo deri më tani ka qenë dhe është e angazhuar si pedagoge e jashtme në disa universitete në Shqipëri e Kosovë, bashkëpunuese në projekte, gazetarë, mësuese, kërkuese shkencore pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në QSA, Tiranë etj. Ka marrë pjesë në disa trajnime, duke u lauruar edhe me certifikata e mirënjohje.

Veprimtaria e saj është shumëplanëshe: ka jo pak shkrime publicistike (16), artikuj që shtjellojnë çështje të krijimtarisë popullore e të letërsisë artistike, kritika e recensione etj. Ka marrë pjesë në një varg konferencash shkencore në vend dhe jashtë.

Nga të dhënat që na sjell kandidatja, komisioni recensues konstaton se dr. sc. Rovena Vata është një intelektuale e formuar, hulumtuuese e pedagoge e dëshmuar; por fusha e specializimit dhe e veprimtarisë kërkimore-shkencore të saj nuk përkon me lëndët për të cilat ka konkurruar. Nga ana tjetër, në dokumentacionin e saj nuk gjetëm vendim për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT së Kosovës, që sipas kushteve të konkursit përkatës, llogaritet si **aplikacion me dokumente të pakompletuara**.

Mbështetur në kriteret e konkursit për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, aplikantja dr. sc. Rovena Vata nuk i plotëson kushtet juridike për t'u zgjedhur mësimdhënëse. REFUZOHET.

### 3. Të dhënat mbi kandidatin:

|                            |  |
|----------------------------|--|
| Emri dhe mbiemri:          | <b>Ragip Gjoshi</b>  |
| Datëlindja dhe vendlindja: | 15. 01. 1957, Sankoc, Drenas (Glllogoc), Republika e Kosovës   |
| Gradat shkencore:          | Studimet themelore i mbaroi në Fakultetin e gazetarisë (në Degën e Shkencave Shoqërore dhe të Komunikimit Masiv) dhe në Fakultetin e Filologjisë (në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare) në Prishtinë.<br>Master i ekonomisë (Fakulteti Ekonomik, Prishtinë)<br>Master i historisë (Fakulteti Filozofik, Prishtinë)<br>Doktorant i ekonomisë – Administrim publik (Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Shqipëri)<br>Doktor i gjuhësisë - Didaktikë e gjuhës shqipe (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë; Universiteti i Tiranës, Shqipëri). |

Në bazë të të dhënave bio-bibliografike, komisioni vlerësues konstaton se kandidati Ragip Gjoshi ka mbaruar studimet themelore të gazetarisë si dhe të filologjisë në Prishtinë (kjo e fundit nuk dëshmohet me diplomë); pastaj ka fituar

gradën master i ekonomisë dhe master i historisë. Aktualisht është doktorant i ekonomisë dhe ka doktoruar në gjuhësi në fushën e didaktikës së gjuhës shqipe. Për këtë të fundit ka dorëzuar vërtetim se ka doktoruar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Tiranë në temën "Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)", por i mungon certifikata e barasvlerësimit të diplomës së doktoraturës nga MASHT e Kosovës.

Nga ana tjetër, rezulton se kandidati dr. sc. Ragip Gjoshi ka një përvojë të pasur arsimore, drejtuese e organizative në karrierën e tij: mësimdhënës i Gjuhës Shqipe dhe i Letërsisë, drejtor i shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi" në Sankoc, Drenas; gazetar, redaktor e kryeredaktor revistash, përgjegjës i Zyrës për Informim – zëdhënës në komunën e Drenasit, drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike në komunën e Drenasit, këshilltar i ministrit të Arsimit të Republikës së Kosovës, mësimdhënës i angazhuar në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, profesor i angazhuar në Kolegjin "Biznesi" në Prishtinë, aktualisht është drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur në MASHT.

Edhe veprimtarie e tij krijuese është e pasur. Deri më tani ka botuar një dramë, poezi, poema dhe një monografi. Ka marrë pjesë edhe në disa konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe ka botuar një varg artikujsh.

Përgjithësisht, aplikanti dr. sc. Ragip Gjoshi ka një formim profesional shumëplanësh: gazetar, ekonomist, historian e filolog; por i mungon specializimi i ngushtë dhe veprimtaria profesionale për lëndët në të cilat ka konkurruar. Nga ana tjetër, në dosjen e tij nuk gjetëm diplomë të doktoraturës të nostrifikuar nga MASHT e Kosovës. Rrjedhimisht, në bazë të konkursit përkatës, **dosja e aplikantit dr. sc. Ragip Gjoshi konsiderohet e pakompletuar.**


Andaj, duke u mbështetur në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në kriteret e konkursit publik, kandidati z. Ragip Gjoshi nuk i plotëson kushtet juridike për t'u propozuar për mësimdhënës. REFUZOHET.

## PROPOZIM


Në bazë të gjithë asaj që u tha deri më tani, në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe me kriteret e konkursit të shpallur për personelin akademik, kemi nderin dhe kënaqësinë që Senatit të këtij Universiteti t'i propozojmë që kandidatin dr. sc. **Asllan Hamiti** ta zgjedhë mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në titullin **profesor i asocuar** (prof. asoc. dr.) për lëndët **Kulturë gjuhe, Fonetikë, Histori e gjuhës standarde, Dialektologji, Metodologji e gjuhës amtare dhe Filologji shqiptare (në programin e Gjuhës Shqipe).**

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

- |            |                            |
|------------|----------------------------|
| 1. Kryetar | prof. dr. Haki Ymeri       |
| 2. Anëtar  | prof. dr. Ali Jashari      |
| 3. Anëtar  | prof. as. Shkëlqim Millaku |



Prizren, më 03. 09. 2015



## RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Në bazë të vendimit të zgjedhjes së Komisionit recensues për vlerësimin e dokumentacionit të aplikantëve që kanë konkurruar për mësimdhënës në Konkursin e publikuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" i Prizrenit për stafin akademik me nr. ref. 01-323 të datës 26. 08. 2015, në kriteret e konkursit publik për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit nr. 01-289 të datës 31. 07. 2015, Komisioni recensues, duke u falënderuar për besimin e dhënë, ka kënaqësinë të shkruajë këtë raport:

### Raporti i recensionit

Fakulteti: Fakulteti i Filologjisë - Prizren  
Lëndët: Gjuhë amtare I, II, III (Programi i Gjuhës gjermane);  
Leksikologji, Gjuhësi ballkanike dhe Sociolinguistikë.

Kandidatët: 1. dr. sc. Flamur Shala dhe  
2. dr. sc. Ragip Gjoshi

### Komisioni recensues:

1. Kryetar prof. dr. Haki Ymeri  
2. Anëtar prof. dr. Ali Jashari  
3. Anëtar prof. ass. dr. Shkëlqim Millaku

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti: profesor asistent (prof. ass.).

Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatitët, Komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

1. Të dhënat për kandidatin Flamur Shala:

Emri dhe mbiemri: **Flamur Shala**

Datëlindja dhe vendlindja: 06. 09. 1963, Prishtinë, Republika e Kosovës

Gradat shkencore: Profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, nota mesatare mbi 8); Magjistër i shkencave të filologjisë (Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë); Doktor i shkencave të filologjisë (barasvlerësimi i diplomës së doktoraturës nga MASHT e Kosovës nr. 6/4 -793).

Titujt akademikë: Nuk ka.

Viti kur është fituar titulli aktual:

Departamenti/fakulteti:

Universiteti:

**1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor**

Kontributi shkencor i kandidatit dr. sc. Flamur Shala

Bazuar në jetëshkrimin e kandidatit dhe në dëshmitë e ofruara, kandidati ka një kontribut solid në fushën shkencore.

Disa nga publikimet shkencore të kandidatit që i veçojmë janë:

- Përdorimi i drejtë i trajtës **iu**, Bota e Re, 1997.
- Aspekte të përdorimit të gjuhës standarde shqipe në institucionet shkollore në Kosovë SNGjLKSh, 2010, nr. 1, f. 433-436.
- Të mësuarit dhe përdorimi i shqipes standarde në shkolla fillore dhe të mesme në Kosovë SNA, 2012, nr. 1, 106-109.
- Mbledhjet e drejtshkrimit në Prishtinë deri te Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë, SNA, Shkup.
- Shqipja standarde dhe institucionalizimi i saj, Shkodër, 2013.
- Studime të botuara në revista vendore dhe ndërkombëtare.

- Redaktimi dhe lekturimi i teksteve të ndryshme shkollore dhe të librave shkencore e artistike.

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidati dr. sc. Flamur Shala ka disa vite përvojë si mësimdhënës i angazhuar në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë në vitet 2010-2011, por edhe në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, në vitin 2015. Nga viti 2011/2012 punon në BPrAL AAB në Prishtinë, mësimdhënës-ligjërues i lëndëve: Morfologji e gjuhës shqipe, Sintaksë e gjuhës shqipe, Shqipe standarde dhe Stilistikë e gjuhës shqipe.

Në mësimdhënie parauniversitare ka disa vjet përvojë pune. Kandidati ka punuar mësimdhënës dhe drejtor i shkollës së mesme elektroteknike "Gjin Gazulli" në Prishtinë. Ishte zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe kreu disa detyra të tjera shoqërore.

## 3. Mobiliteti i kandidatit

Kandidati Flamur Shala studimet themelore i mbaroi në vitin 1990 në Fakultetin e Filologjisë, Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Prishtinë, me notë mesatare mbi tetë (Profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe). Në janar të vitit 2009 i mbaroi studimet pasuniversitare në Degën e Gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë (Magjistër i Shkencave Filologjike).

Doktoroi në tetor të vitit 2011 në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Universitetin "Shën Cirili e Metodi", në Shkup (Doktor i Shkencave Filologjike, nr. 3086). Diplomën e ka të barazvlerësuar nga **MASHT-i me nr.6/4-793**.

Kandidati përveç angazhimit të tij në mësimdhënie universitare dhe parauniversitare me disa vite përvojë, ai ka dëshmuar se është aktiv edhe në pjesëmarrje e konferencave shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Në udhëheqjen arsimore ka dëshmuar pjekuri dhe rezultate të arsyeshme. Ka qenë pjesëmarrës në disa trajnime profesionale për ngritjen e standardit të cilësisë dhe të vetë-vlerësimit në arsim.

Kandidati dëshmon se ka qenë redaktues, recensues dhe lektor i disa monografive dhe revistave shkencore.

Mbështetur në të dhënat që u prezantuan dhe në kriteret normative të parapara nga Universiteti, kandidati dr. sc. Flamur Shala i plotëson kushtet e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, Nenit 173 dhe kushtet e parapara në konkursin publik nr. 01-289 për t'u propozuar për **PROFESOR ASISTENT**.

2. Të dhënat për kandidatin Ragip Gjoshi:

Emri dhe mbiemri: **Ragip Gjoshi**

Datëlindja dhe vendlindja: 15. 01. 1957, Sankoc, Drenas (Glllogoc), Republika e Kosovës

Gradat shkencore: Studimet themelore i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë (në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe) në Prishtinë.  
Mbaroi edhe Fakultetin e Gazetarisë (në Degën e Shkencave Shoqërore dhe të Komunikimit Masiv).  
Master i ekonomisë (Fakulteti Ekonomik, Prishtinë).  
Master i historisë (Fakulteti Filozofik, Prishtinë).  
Doktorant i ekonomisë – Administrim publik (Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Shqipëri).  
Doktor i gjuhësisë - Didaktikë e gjuhës shqipe (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë; Universiteti i Tiranës, Shqipëri).

Në bazë të të dhënave nga jetëshkrimi i kandidatit, komisioni vlerësues konstaton se dr. sc. Ragip Gjoshi studimet themelore i ka mbaruar në Fakultetin e Filologjisë dhe të Gazetarisë në Prishtinë; pastaj mbaroi master në ekonomi dhe master në histori. Aktualisht është doktorant i ekonomisë. Kandidati ka doktoruar në gjuhësi në fushën e didaktikës së gjuhës shqipe. I njëjti dëshmon me vërtetim se ka doktoruar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Tiranë në temën "Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)". Për fat jo të mirë, në dosjen e kandidatit nuk dëshmohet se ka **nostrifikim**.

Konkursi publik i shpallur nga Universiteti "Ukshin Hoti" të Prizrenit nr. 01-289 ka paraparë: "Aplikacionet e pas afati dhe ato të pakompletuara – të pa **nostrifikuara** nga MASHT, nuk do të pranohen, nuk do të merren në shqyrtim".

Kandidati dr. sc. Ragip Gjoshi ka një përvojë të pasur arsimore, drejtuese e organizative në karrierën e tij, si: mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, drejtor

i shkollës së mesme "Luigj Gurakuqi" në Sankoc, Drenas; gazetar, redaktor e kryeredaktor revistash, përgjegjës i Zyrës për Informim – zëdhënës në komunën e Drenasit, drejtor i Departamentit të Shërbimeve Publike në komunën e Drenasit, këshilltar i ministrit të Arsimit të Republikës së Kosovës, mësimdhënës i angazhuar në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, profesor i angazhuar në Kolegjin "Biznesi" në Prishtinë, aktualisht është drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Arsim Profesional dhe Arsim për të Rritur në MAShT etj.

Kandidati ka një formim profesional shumëplanësh: filolog, gazetar, ekonomist, historian.

Mbështetur në konkursin publik të UPZ-së, në bazë të të dhënave që gjejmë në dosjen e kandidatit, mund të konkludohet se dosja e tij është e pakompletuar, meqë **nuk ka nostrifikim**.


Andaj, duke u mbështetur në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në kriteret e konkursit publik, kandidati z. Ragip Gjoshi nuk i plotëson kushtet juridike për t'u propozuar për mësimdhënës. REFUZOHET.

### PROPOZIM

Në bazë të asaj që u tha deri më tani, në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në kriteret e konkursit të shpallur për personelin akademik, kemi nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor të Fakultetit të Filologjisë dhe Senatit të këtij Universiteti t'i propozojmë që kandidatin dr. sc. **Flamur Shala** ta zgjedhë mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë në titullin **profesor asistent** (prof. ass. dr.) për lëndët: **Gjuhë amtare I, II, III** (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Gjermane); **Leksikologji, Gjuhësi ballkanike** dhe **Sociolinguistikë** (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe).

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

- |            |                                 |
|------------|---------------------------------|
| 1. Kryetar | prof. dr. Haki Ymeri            |
| 2. Anëtar  | prof. dr. Ali Jashari           |
| 3. Anëtar  | prof. ass. dr. Shkëlqim Millaku |



Prizren, më 04. 09. 2015

|  |                  |
|--|------------------|
| Universiteti i Prizrenit<br>University of Prizren<br>Univerziteti Prizren<br>"UKSHIN HOTI" |                  |
| Pranuar me dt. 14.09.2015  |                  |
| Zyra e pranimit  | Nr. i protokolit |
| 308  | 02-283           |



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES  
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

Raporti i recensionit

Fakulteti Filologjisë :

**Lëndët: Hyrje në shkencat e letërsisë, Teoria e letërsisë, Letërsi për fëmijë, Letërsi popullore, Folklor arbëresh, Kritikë letrare, sipas konkursit të 31 korrikut të këtij viti.**

Kandidati: Merxhan Avdyli

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: Merxhan Nazmi Avdyli

Datëlindja dhe vendlindja: 7 janar 1961, Sadovinë e Jerlive, Viti.

Gradat shkencore: **Doktor i shkencave filologjike**



Titujt akademikë:

Viti kur është fituar titulli aktual:

Fakulteti i Filologjisë, Dega e Letërsisë Shqipe

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Komisioni recensues:

1. Kryetar, Prof. Dr. Sabahajdin Cena, 
2. Anëtar, Prof. Dr. Enver Mehmeti
3. Anëtare, Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-Baliu, 

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:

Prof. ass

**1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor**

Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

| Veprimtaria shkencore e kandidatit   | Prej fillimit të karrierës | Gjatë 4 vjetëve të fundit |
|--|----------------------------|---------------------------|
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor*                                     |                            |                           |
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor**  |                            |                           |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor*                       | 3                          | 3                         |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor**                            |                            |                           |
| Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor |                            |                           |
| Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)                           | 7                          | 5                         |
| Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)            | 7                          | 3                         |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor              | /                          | /                         |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja                            | /                          | /                         |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe                             | 3                          | 2                         |
| Numri i librave ose monografive të botuara si koautor  | 6                          | 2                         |
| Kontribute të tjera shkencore dhe artistike<br>Është autor i 6 përmbledhjeve të poezive                  | 4                          | 2                         |

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

\***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

\*\***Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

**Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë originalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

| Të dhënat për punimet:<br>Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet  | "Impact factor"    | Nr. i citimeve |
|--|--------------------|----------------|
|  |                    |                |
| Të dhënat për punimet:<br>Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet  | pa "Impact factor" | Nr. i citimeve |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. "Struktura e poemës së Dritëro Agollit" ("Educologia", Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 5/2011, fq. 145-148). Punim studimor KDU 821.18-1.09</li> <li>2. "Simboli në poezinë e Ismail Kadaresë" ("Jeta e re", revistë letrare, nr. 1, Prishtinë, 2012, f. 331-341).</li> <li>3. "Figura e krahasimit në poezinë e Ismail Kadaresë" (Figura comparatiei in poezia lui Ismail Kadare), "ALBANEZUL" periodic al Uniunii Culturale a Albanezilor din Romania ("SHQIPTARI, Peridok i Bashkësisë Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë), Nr 8, 2012, fq. 13-15, Bucuresti (Bukuresht), ISSN 122-6925.</li> <li>4. "Poezia e Ismail Kadaresë dhe kritika letrare", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 31/2, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2012, fq. 99-110. ISBN 978-9951-00-156-4</li> <li>5. "Robëria në funksion të identitetit në poezinë e Bajram Kosunit", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 32/2, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2013, f.615-620. ISBN 978-9951-00-165-6.</li> </ol> |                    |                |

| Të dhënat për punimet tjera:  |  |  |
|---|--|--|
| <i>Libra studimore të botuara</i>   |  |  |
| 1. <i>Sprova zbuluese të poetikës, "Brezi 81", Prishtinë, 2005. ISBN 978-9951-424-06-6.</i>   |  |  |
| 2. <i>Studime për Agollin në Kosovë, "Argeta LMG", Tiranë, 2006.</i>  |  |  |
| 3. <i>Përsosmëria shkrimore (poetika e romanit Kronikë në gur të Ismail Kadaresë) "MA", Prishtinë, 2009. ISBN 978-9951-424-23-3</i>               |  |  |
| 4. <i>Vargu agollian (studim për trajtat e vargut dhe të strofës në poezinë e Dritëro Agollit), "MA", Prishtinë, 2010. ISBN 978-9951-424-27-1</i> |  |  |
| 5. <i>Dritësime letrare, "MA", Prishtinë, 2013. ISBN 978-9951-424-45-5</i>  |  |  |
| 6. <i>Vargu kadarean, "Brezi '81", Prishtinë, 2014.</i>   |  |  |
|   |  |  |

Vërejtje lidhur me tabelën 2:

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së (neni 175, 176 dhe 177). *Punime kryesore të publikuara dhe të shqyrtuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare* konsiderohen, në radhë të parë, punimet e publikuara në revista me "faktor impakti" e pastaj edhe punimet origjinale të botuara në revistat shkencore ndërkombëtare me "peer review" në lëminë ku konkurron kandidati.

Në këtë tabelë duhen të shënohen vetëm punimet nga fusha e ngushtë shkencore në të cilën kandidati konsiderohet "autor kryesor". Autor kryesor konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi personale lidhur me punimet e radhitura në këtë tabelë Publikimet e radhitura në këtë tabelë (edhe në formë të shtypur) duhet t'i dorëzohen si dëshmi Komisionit të Studimeve së bashku me raportin e recensionit.

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale)

Kandidati është studiues i letërsisë, kritik letrar, publicist, poet, intelektual me magjistraturë edhe në fushën e diplomacisë, dhe njëri prej organizatorëve të demonstrave të vitit 1981 në Prishtinë, së andejmi edhe ish-i burgosur politik. Ka punuar si redaktor e kryeredaktor nëpër shumë gazeta, revista, radio e televizione. Për një mandat ishte zëvendësministër në Qeverinë e Kosovës. Në periudhën prej vitit 2008 deri më 2011 punoi ai Drejtor i Zyrës për Vlerësimin e Cilësisë në Kolegjin Universitar "Biznesi" të Prishtinës, e pastaj si i angazhuar vazhdoi veprimtarinë akademike në

Fakultetin e Edukimit. Në vitin akademik 2010/11, punon në Prishtinë, pastaj edhe në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe në Programin e AKM-së. Në vazhdim punon në Institucionin e Avokatit të Popullit, e pastaj edhe në Fakultetin Filozofik e në Universitetin "Kadri Zeka" të Gjilanit, dhe vazhdoi sërish në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit "Hasan Prishtina" e në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit, për lëndët nga fusha e letërsisë.

Në maj të vitit 2014 zgjedhet Anëtar i Këshillit të Përkohshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" të Gjilanit. Kandidati është fitues i disa çmimeve për letërsi, ndërsa në vitin 2014 fitoi edhe çmimin për librin më të mirë të vitit nga fusha e kritikës letrare të cilin e ndan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)*

### 4. Mobiliteti i kandidatit

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)*

### 5. Titulli i cili propozohet



*(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).*

Komisioni recensues gjatë seancave të veta trajtoi aplikacionin e kandidatit Dr. Merxhan Avdyli, shqyrtoi materialin e ofruar dhe

#### K o n s t a t o i

se kandidati Merxhan Avdyli , i lindur më 7 janar 1961 në Sadovinë të Jerlive, Viti, i doktoruar më 9. 10. 2012, në Fakultetin e Filogjisë të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë, i plotëson kushtet për t'u zgjedhur në frymën e dispozitave të Statutit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", **prandaj edhe i propozohet për kandidat në frymën e akteve normative të këtij organi dhe në frymën e konkursit të 31 korrikut të këtij viti.**

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetar, Prof. Dr. Sabahajdin Cena, 
2. Anëtar, Prof. Dr. Enver Mehmeti, \_\_\_\_\_
3. Anëtare, Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj- Baliu, 



**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES  
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK**

Raporti i recensionit

Fakulteti i Filologjisë

**Lëndët: Hyrje në shkencat e letërsisë, Teoria e letërsisë, Letërsi për fëmijë, Letërsi popullore, Folklor arbëresh, Kritikë letrare, sipas konkursit të 31 korrikut të këtij viti.**

Kandidati: **Teuta Nuhi Vinca - Kafexholli**

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Teuta Nuhi Vinca - Kafexholli**

Datëlindja dhe vendlindja: 4 tetor 1963 në Strugë, Maqedoni.

Gradat shkencore: Doktore e shkencave filologjike

Titujt akademikë: /

Viti kur është fituar titulli aktual:

Fakulteti i Filologjisë "Blaze Koneski", Shkup

Universiteti: "Sv. Kiril i Metodij", Shkup.

Komisioni recensues:

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetar, Prof. Dr. Sabahajdin Cena, 

2. Anëtar, Prof. Dr. Enver Mehmeti, \_\_\_\_\_

3. Anëtare, Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj, 

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:

**Prof. Ass**

## 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

### Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

| Veprimtaria shkencore e kandidatit   | Prej fillimit të karrierës | Gjatë 4 vjetëve të fundit |
|--|----------------------------|---------------------------|
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor *                                    | /                          | /                         |
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor**  | /                          | /                         |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor *                      | /                          | /                         |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor**                            | /                          | /                         |
| Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor | /                          | /                         |
| Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)                           | 6                          | 5                         |
| Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)            | /                          | /                         |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor              | 4                          | 4                         |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja                            | /                          | /                         |
